VENDIM
Nr. 187, datë 6.6.2023

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "PROINFINIT CONSULTING" SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "d", nenit 5, pika 1, germa "d" dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.6.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1378/3 prot., datë 1.6.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi licencimin e shoqërisë 'Proinfinit Consulting' sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Proinfinit Consulting" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1378 prot., datë 8.5.2023, aplikoi për t'u licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe me vendimin nr. 174, datë 18.5.2023, bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë sipas kërkesës së protokolluar në ERE.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 19.5.2023 dhe 20.5.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 28.5.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1379/3 prot., datë 24.5.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria në vijim nëpërmjet shkresës nr. 1379/4 prot., datë 25.5.2023, përcolli të plotë dokumentacionin e kërkuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.4); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/D të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria "Proinfinit Consulting" sh.p.k., ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, germat "a", "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat "a", "b", "c" dhe "d"; për pikën 1.3, germat "a", "b" dhe "c" dhe për pikën 2.4, germat "a", "b", "c" dhe "d".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Proinfinit Consulting" sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti